

MNN QENDRORE



MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

22 tetor 2025

NJË SHIKIM I SHPEJTË MNN



Një copë kek dhe Tre Fjalë të Vogla



Një grua shkoi të blinte një kek në një zonë pranë vendndodhjes Águas Fundas, një zonë periferike e qytetit të Praias në Cabo Verde.

Kur ajo arriti, keku nuk ishte ende gati, kështu që ajo doli për një shëtitje. Ajo arriti në një lagje ku nuk kishte kishë. Fryma e Zotit e mbushi me dhembshuri për atë komunitet. Ajo ndjeu se Zoti po i tregonte këtë vend si një fushë misioni. Që nga ai moment, keku që shkoi të blinte humbi çdo rëndësi sepse tashmë ajo lagje u bë interesi i saj më i madh.

Ajo mësoi se emri i lagjes ishte Águas Fundas, që do të thotë "Ujëra të thella". Javën tjetër ajo u tha dy personave në kishën e saj dhe pastorit: "Ne do të shkojmë të shërbejmë në Águas Fundas". Kështu, tre persona të tjerë iu bashkuan asaj dhe filluan të shërbenin atje, duke u mbështetur në parimet e Oralitetit dhe përdorimin e historive që lidhen me përvojat e jetuara dhe të përbashkëta.

Me të mbërritur në komunitet, ky grup misionarësh vendas takuan një grua të zonës e cila i pyeti: "Çfarë po bëni këtu?" Ata u përgjigjën: "Ne po mësojmë Fjalën e Perëndisë".

Grupi I misionit njihej si "Três Palavrinhas" (Tre Fjalë të Vogla) për shkak të një kënge që ata e këndonin shpesh:

Vetëm tre fjalë
I mësova përmendësh
Perëndia është Dashuri
La, la la, la la, la la la la, la la



Të gjithë fëmijët u kërkuan atyre ta këndonin këtë këngë në çdo takim. Fëmijët në fotografinë e mësipërme ishin dëgjuesit e parë. Ata vinin për të kënduar "tre fjalët" çdo të Die pasdite me misionarët vendas.

Dhe kështu ky grup i vogël shërbëtorësh të bindur vazhduan misionin e tyre, duke shkuar nga shtëpia në shtëpi. Familjet u kthyen tek Zoti, të gjitha shtëpitë. Ditë pas dite, ata fituan zemrat e njerëzve të Águas Fundas. Ata trokitën pothuajse në çdo derë të lagjes. Ata uleshin me njerëzit, hanin bashkë, qeshnin, ndihmonin, përqafonin, luanin dhe mësonin Ungjillin e gjallë që ndryshon jetë në shumë mënyra; sa herë që ndanin Lajmin e Mirë, komuniteti afrohej më shumë me njëri-tjetrin.




Disa muaj më vonë, kisha mori me qira një shtëpi me një garazh për shërbesat dhe një hapësirë për një kopsht fëmijësh. Ata u bënë kisha e parë e Krishterë dhe kopshti i parë në lagje. I gjithë komuniteti u gëzua, dhe vitin e kaluar Kisha e Nazaretasit të Águas Fundas u organizua zyrtarisht. Sot, ajo ka një numër të mjaftueshëm besimtarësh besnikë të të gjitha moshave. Disa tashmë janë pagëzuar dhe kisha vazhdon të lulëzojë.

Nga një ecje për në furrin e bukës, për të blerë një kek, lindi një mision dhe nga ky mision familje të tëra u arritën. Dhe hiri i Zotit vazhdon ta transformojë këtë komunitet. Disa tani e quajnë lagjen "Fonte de Águas Vivas", që do të thotë "Burimi i Ujrave të Gjalla", sepse shumë njerëz kanë kaluar nga vdekja në jetë atje.

Përshtatur nga historia e ndarë nga Angela Moreno, Kepi i Gjellbër.

Rajonin e Afrikës



Kepi i Gjellbër

Kepi i Gjellbër ndodhet 300 milje (483 kilometra) në perëndim të bregdetit Afrikan nga Senegali, në Rajonin e Afrikës, Kepi i Gjellbër, një komb që flet Portugalisht, është një arkipelag me dhjetë ishuj vullkanikë në Fushën e Frankofonisë të Afrikës Perëndimore. Ajo fitoi pavarësinë nga Portugalia në vitin 1975, si një republikë socialiste me një parti, dhe më vonë në 1990

miratoi një kushtetutë të re që stabilizoi vendin, si politikisht ashtu edhe ekonomikisht, nën një sistemi demokratik shumëpartiak. Më shumë se 46% e popullsisë është nën moshën 25 vjeç, gjë që paraqet mundësi të mëdha për të ardhmen. Kisha e Nazaretasit u themelua në Kepin e Gjellbër në vitin 1901, gjë që e bën atë një nga veprat më të vjetra të këtij denominacioni. Aktualisht, Kisha e Nazaretasit është kisha më e madhe Protestante në vend. Nuk ka më misionarë të huaj që shërbejnë në Kepin e Gjellbër. Të gjitha shërbesat drejtohen nga udhëheqës vendas dhe kisha vazhdon të maturohet. Dr. Eugenio Duarte, Mbikëqyrësi i Përgjithshëm i 37-të në Kishën e Nazaretasit, i zgjedhur më 30 Qershor 2009 në Asamblenë e Përgjithshme të 27-të, ka lindur në Kepin e Gjellbër.



9,049 Anëtarë



59 Kisha të Organizuara Plotësisht; 6 Kisha të Paorganizuara Ende.



21 Shërbërorë të Liçensuar dhe 58 Shërbëtorë të Shuguruar në 4 Distrikte, dhe 5 Zona Pioniere

LUTET

- Lutuni për udhëheqësit e kishës në Kepin e Gjellbër, për Seminarin atje dhe për klerin dhe laikët ndërsa kërkojnë urtësi për të ardhmen e Kishës në kohë ndryshimi.
- Lutuni për shërbesa të reja që po fillojnë nga Nazaretasit besnikë si ajo e përmendur në historinë e Águas Fundas.



Lëvdim

- Lavdi Perëndisë për besnikërinë e Tij dhe favorin që i ka dhënë Kishës së Nazaretasit për të pasur ndikim të shenjtë në Kepin e Gjellbër për 124 vjet.
- Lavdi Perëndisë për ata që po i përgjigjen thirrjes së Zotit në jetën e tyre dhe për Seminarin në Kepin e Gjellbër që po përpaket t'i përgatisë ata për shërbesë.



A mund të shërbeni?

A po ju thërret Zoti të bashkoheni në misionin e Tij në Rajonin e Afrikës? Për më shumë informacion, [klikoni këtu](#).

NMI Central është i disponueshëm në një arkiv PDF të kuruar. Për të lexuar botimet e mëparshme, [klikoni këtu](#).

